



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2540/Prot.
15

Patos, më 06/08 / 2026

NJOFTIM

DËGJESË PUBLIKE ME TEMË: REFORMA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE 2.0
Projektligji “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në
Republikën e Shqipërisë”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe shkresës nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me nr. 3573 prot., datë 31.07.2026 me lëndë: “Dërgohet Draft për Reformën Administrativo-Territoriale”,

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Enjte** në datë **10.09.2026, ora 18:00**, te Bar Gjermani Patos do të organizohet dëgjesa publike me bizneset me temë: **“Reforma Administrative-Territoriale 2.0”** me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; banorë; biznese të bashkisë Patos; përfaqësues të bashkisë Patos e komunitetit dhe të gjithë grupet e interesuara.

Këto konsultime publike synojnë realizimin e një procesi transparent mbi marrjen e opinioneve, rekomandimeve të gjithë banorëve të bashkisë Patos dhe njësive të vetqeverisjes vendore, grupet e interesit dhe aktorët e tjerë mbi reformën dhe projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Kalendarin e Konsultimeve Publike e gjeni te publikuar në faqen zyrtare të bashkisë në linkun: <https://bashkiapatos.gov.al/konsultime-publike/>

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Faton Duro